

# Jak Ndoka




GJYQATAR PRANË GJYKATËS SË RRETHIT LEZHË

Deklaratat e analizuar:

13 Deklarata të analizuar

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2016)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2016



Pasuria bruto është rritur 10.5 herë.

+ 922,957 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Bankë

1,600,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Likuiditete në Cash

2,863,070

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e Luajtshme

500,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e Paluajtshme

8,293,850

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga nga funksioni	14,994,792	57.2%
Të ardhura nga paga e familjarëve	6,130,013	23.4%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	4,241,521	16.2%
Të ardhura nga Qira	630,000	2.4%
Dhurata në cash	230,324	0.9%
<b>Total</b>	<b>26,226,650</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 13 vite rezultoi:

1 deklaratë Me probleme  
12 deklarata Pa Probleme

Në vitin 2008, subjekti Jak Ndoka rezultoi me burime financiare të pamjaftueshme në vlerën 473,231 lekë për të justifikuar shtesën e asetit apartament banimi 73m<sup>2</sup> në Shëngjin me vlerë 2,400,000 lekë, pavarësisht të ardhurave vjetore të deklaruara dhe detyrimit të pashlyer ndaj firmës në vlerë 900,000 lekë.

Në vitin 2007, subjekti deklaroi shtesë aseti apartament banimi dhe njësi shërbimi në Lezhë me vlerë totale 3,800,000 lekë, me burim financiar shitjen e një apartamenti të mëparshëm me vlerë 5,300,000 lekë. Apartamenti i shitur deklarohet si burim edhe për blerjen e apartamentit në Shëngjin në vitin 2008, por subjekti nuk e ka deklaruar më parë huanë që i detyrohej blerësi.

Në vitin 2011 subjekti deklaroi të ketë përfituar tokë pemtore dhe arë në Pllanë, Lezhë, sipas ligjit numër 7501 për tokën, në bashkëpronësi 1/6 pjesë të sipërfaqes totale 6,000m<sup>2</sup>, pa deklaruar vlerë aseti.

Në vitin 2012, subjekti deklaroi shtesë apartament banimi sipërfaqe 103m<sup>2</sup> në Tiranë, për të cilin deklaroi vetëm pagesën 15,000 euro, me burim kursimet në cash për vitet 2009-2011. Në deklarim mungon vlera e plotë e asetit dhe deri në fund të vitit 2016, nuk ka të dhëna të tjera për pagesa shtesë.